REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 122/17
Datë/Datum. 08.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEË BODY**

# AKT PËRCJELLËS

| | |
|---|---|
| REFERENCË: | **122/17** |
| PËR: | - Zyrtarin e prokurimit të AK-së: **Komuna e Pejës**<br>- Parashtruesit të ankesës: **"Selmans Network"sh.p.k.-Prishtinë, "Krasniqi"sh.p.k.-Prishtinë, "Schafberger gmbh"-Drenas, NTP "Beni"-Suharek, dhe "Aroma Plus"sh.p.k.-Prishtinë.** |
| CC: | - Panelit Shqyrtues në OSHP,<br>- Arkivës në OSHP |
| NGA: | Sabrije Bullatovci - Ekspert Shqyrtues i Prokurimit Bullatovci |
| TEMA: | Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar: **OE "Selmans Network"sh.p.k.-Prishtinë, OE"Krasniqi"sh.p.k.-Prishtinë, OE"Schafberger gmbh"-Drenas, OE NTP "Beni"-Suharekë, dhe OE "Aroma Plus"sh.p.k.-Prishtinë**, me numër protokollit: **122/17**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre"**, me nr. të prokurimit: 635/17/038/215, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues: (AK) – Komuna e Pejës. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Lokacioni: | Prishtinë | Data: | 08.05.2017 |
| PËR AKTIVITET | | | X |
| SIÇ ËSHTË KËRKUAR | | | X |
| PËR KOMENTE | | | X |
| PËR INFORMIMIN TUAJ | | | X |

*Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit:* **"Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre", me nr. të prokurimit: 635/17/038/215,** iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **Komuna e Pejës,** si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues: **"Selmans Network"sh.p.k.-Prishtinë, "Krasniqi"sh.p.k.-Prishtinë, "Schafberger gmbh"-Drenas, NTP "Beni"-Suharekë, dhe "Aroma Plus"sh.p.k.-Prishtinë**, me numër protokollit: **122/17.**

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:
*AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.*

*Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.*

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Bullakaj | | **27.04.2017** | | **02.05.2017** | | 08.05.2017 |
| *Nënshkrimi i ekspertit* | | *Data e autorizimit të ekspertizës* | | *Data e fillimit të ekspertizës* | | *Data e dorëzimit të raportit* |

***N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit***

Me datën: **21.04.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **122/17,** e parashtruar nga OE: **"Selmans Netëork"sh.p.k.-Prishtinë, "Krasniqi"sh.p.k.-Prishtinë, "Schafberger gmbh"-Drenas, NTP "Beni"-Suharekë, dhe "Aroma Plus"sh.p.k.-Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre", me nr. të prokurimit: 635/17/038/215**, iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **"Selmans Netëork"sh.p.k.-Prishtinë, "Krasniqi"sh.p.k.-Prishtinë, "Schafberger gmbh"-Drenas, NTP "Beni"-Suharekë, dhe "Aroma Plus"sh.p.k.-Prishtinë**,

Konform nenit 113, të Ligjit Nr. 04/L-042, si dhe konform njoftimit të OSHP-së të datës: 19.11.2014 me nr. prot. 848/14. Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komuna e Suharekës.**

**N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues: "Selmans Netëork"sh.p.k.-Prishtinë, "Krasniqi"sh.p.k.-Prishtinë, "Schafberger gmbh"-Drenas, NTP "Beni"-Suharek, dhe "Aroma Plus"sh.p.k.-Prishtinë.**

***Pikat e Ankesës:***

**- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

**- Neni 7 Barazia në trajtim/jo-diskriminimi dhe transparenca**

**- Neni 8 Planifikimi i prokurimit –**

**Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës**

**- Neni 35 Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës.**

***Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:***

Komuna e Pejës me rastin e publikimit të njoftimit për dhënie të Kontratës ka bërë shkelje të rëndë të Ligjit për Prokurimin Publik dhe Ligjit për Konkurrencën, duke dëmtuar kështu OE të licencuar dhe të specializuar e me përvojë që operojnë në tregun e Kosovës. Në të njëjtën kohë AK përmes këtij veprimi të kundërligjshëm ka dëmtuar edhe buxhetin e Komunës së Pejës duke paguar kështu shërbime me shtrenjtë se sa do të mund të paguante apo ka paguar më herët për të njëjtat shërbime:

- AK Komuna e Pejës duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës ka bërë shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik, dhe është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të këtij ligji, konkretisht të nenit 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji. (citojmë)

***a. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.***
***b. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.***

Me anë të kësaj kontrate fondet Publike nuk janë përdorur në mënyrë ekonomike ngase vlera e kontratës me të cilën është shpërblyer "KRM AMBLENTI" është shumë herë më e madhe se sa vlerat e kontratave të më hershme me anë të cilave Komuna e Pejës ka kryer këto shërbime.

2. AK Komuna e Pejës gjithashtu ka bërë shkelje të LPP-së nëntit 7,trajtim/Jo Diskriminimi, paragrafi 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, nga që duke shpërblyer një operator me kontratë me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë ka eliminuar kështu nga konkurrenca dhe nuk ka trajtuar të gjithë OE të cilët do të mund te paraqesin ofertat e tyre ne këtë procedurë te prokurimit. ***(citojmë: neni 7 paragrafi 2, 4utoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.)***

***Më e keqja e gjithë kësaj është sepse Komuna e Pejës ka shpërblyer me kontratë (në formë tinëzare) një kompani e cila nuk ka as përvojën dhe as njohuritë e duar për të kryer shërbimet e pastrimit të Objektive Komunale, një kompani e cila nuk është marrë kurrë me një lloj të shërbimeve të tilla.***

***Në të njëjtën kohë Komuna e Pejës ka shpërblyer me kontratë KRM AMBIENTI edhe për shërbimet e sigurimit fizik kur dihet mirë se për Shërbime të veçanta siç është Sigurimi Fizik i Objekteve kërkohen Leje dhe Licenca të veçanta për kryerjen e këtyre shërbimeve, duke bërë kështu shkelje edhe të paragrafit 5 të po të njëjtit nen. (citojmë: Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit).***

3. Edhe pse me kërkesë të gjithë OE të cilët merren me Shërbimet e Pastrimit dhe të mirëmbajtës së Objekteve dhe në emër të tyre i është dërguar kërkesë për qasje në dokumente zyrtare nga adresa zyrtare e Schafberger komuna e Pejës akoma edhe sot nuk ka kthyer përgjigje për lejimin apo jo të qasjes në këto dokumente duke bërë kështu edhe një tjetër shkelje të LPP-së konkretisht të nenit 10, Mjetet për Promovimin e Transparencës.

(i) AK Komuna e Pejës duke u munduar që të shpërblej në mënyrë të kundërligjshme dhe të shpallë fitues KRM AMBIENTI është munduar që të përdorë si kriter një nga procedurat e lejuara të LPP-së, konkretisht nenin 35, Procedura e Negociuar pa Publikimin e Njoftimit të Kontratës. Ligji i Prokurimit publik lejon një lloj të tillë të procedurës mirëpo, saktëson qartë se kur mund të përdoret një lloj i tillë i procedurës e jo në rastin konkret. E nisim nga paragrafi 1 i këtij neni (citojmë:

***Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës për të ushtruar aktivitetin e prokurimit vetëm në përputhje me këtë nen. KRPP-ja, në përputhje me nenin 87, paragrafin 2, nënparagrafin 2.3 të këtij ligji, duhet të njoftohet nga autoriteti kontraktues në fjalë Brenda dy (2) ditëve nga data kur vendimi për përdorimin e procedurave të tilla është marrë. Autoriteti kontraktues duhet që në njoftim të ofrojë një shpjegim të hollësishëm të fakteve të konsideruara dhe justifikim për përdorimin e procedurës).***

Edhe pse ne skemi mundur të kemi qasje në dokumente dhe të shqyrtojmë shkresat e lëndës dhe komunikimet jemi të bindur se AK. Komuna e Pejës me rastin e Njoftimit apo jo të KRPP-së, nuk ka dhënë arsye të qëndrueshme se pse ka përdorur këtë lloj të Procedurës së Prokurimit Publik. Gjithashtu edhe nëse janë zhvilluar të gjitha procedurat sipas këtij neni AK Komuna e Pejës është në Kundërshtim me këtë nen dhe konkretisht me paragrafin 2 të këtij neni, pika 2.3.

***(citojmë: një kontrate të shërbimeve: i) që pason nga një konkurs projektimi i ushtruar përmes procedurave të hapura ose të kufizuara, dhe që kërkohet , sipas rregullave në fuqi, t'i epet kandidatit të suksesshëm. ii) që do ti epet një autoriteti kontraktues që sipas një akti legjislativ ose rregullativë normativ ose nën-normativ e gëzon një të drejtë ekskluzive për të siguruar shërbimin e tillë.)***

Dhënia e kësaj kontrate nuk ka pasuar nga asnjë konkurs apo procedurë e hapur apo e kufizuar nga e cila OE të cilit i është dhënë kontrata është shpallur fitues apo është vlerësuar në ndonjë procedurë tjetër paraprake që mund ti ketë paraprirë dhënies së kësaj kontrate.

Gjithashtu, OE të cilit i është dhënë kontrata nuk gëzon asnjë të drejt ekskluzive për kryerjen e këtyre shërbimeve ngase ka më shumë se 30 kompani të cilat operojnë në territorin e Kosovës dhe që janë shumë më shumë të specializuara për të kryer shërbime të llojit të tillë të Pastrimit dhe të Mirëmbajtjes së Objekteve përkundrazi KRM AMBIENTI nuk ka as përvojën dhe as njohurinë e duhur për të kryer një lloj të tillë të shërbimeve e aq më pak për të kryer shërbimet e sigurimit fizik te Objekteve të Komunës së Pejës kur dihet mirë për fakti se shërbimet të tilla kërkojnë licenca të veçanta të cilat duhet të merren në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës e për të cilat KRM AMBIENTI as që ka aplikuar ndonjëherë e lër më ti ketë.

AK Komuna e Pejës është në kundërshtim të plotë po te njëjtin nen me ane te cilit është e mundur kundërligjshëm te shpërblej me kontrate KRM AMBIENTI. ***(citojmë: (i) për zbatimin ose ekzekutimin e shërbimeve ose punëve shtesë që nuk ishin përfshirë as në konceptimin4: të një projekti të punëve të dhënë më parë dhe as të paraqitura në kontratën përkatëse të punëve që është përmbyllur më parë, por të cilat, përmes rrethanave të paparashikuara, janë bërë të nevojshme për kryerjen e shërbimeve ose punëve të përshkruara në projektin ose kontratën e tillë. Me kusht që ky nen 35.2.4 (i) të mund të shfrytëzohet vetëm nëse (a) kontrata që i mbulon shërbimet ose punët e tilla shtesë ti epet operatorit ekonomik që është duke i ekzekutuar shërbimet ose punët fillestare dhe (b) shërbimet ose punët e tilla shtesë, teknikisht ose ekonomikisht nuk mund të ndahen nga kontrata kryesore pa i shkaktuar dëme autoritetit kontraktues apo (c) kur punët apo shërbimet e***

*tilla, edhe pse të ndara nga ekzekutimi i kontratës origjinale, janë rreptësisht të domosdoshme për atë kompletim. Më tutje, me kusht që, ky nen 35.2.4(i) të mund të shfrytëzohet vetëm për të mbuluar një ose në shumë kontrata për shërbime ose punë shtesë që vetëm ose së bashku kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë përlind (10%) e vlerës së kontratës fillestare.*

*(ii) Për punë apo shërbime të reja që bëjnë pjesë në përsëritjen e punëve apo shërbimeve të ngjashme dhe që iu besuan operatorit ekonomik të cilit I njëjti autoritet kontraktuese I dha kontratën fillestare, me kusht që punët e tilla të janë në përputhje me një 6rocedu bazik për të cilin kontrata origjinale ishte dhënë sipas 6rocedure6 së hapur ose të kufizuar. Sa më herët që projekti I 6roc të është paraqitur për tender, përdorimi I mundshëm I kësaj procedure do të deklarohet dhe kostoja totale e parashikuar e punimeve apo shërbimeve pasuese duhet të merren në 6rocedure6e nga autoritetet kontraktuese, kur ata të aplikojnë rregullat e vlerësimit të Kapitullit 4. Autoritetet publike mund të përdorin këtë 6rocedure vetëm gjatë një periudhe prej dy viteve pas përfundimit të kontratës fillestare. Me kusht që, sidoqoftë, neni 35.2.4 (ii) mund të shfrytëzohet vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për shërbime të reja që, vetëm ose së bashku kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë përlind (10%) e vlerës së kontratës të mëhershme të shërbimeve).*

Komuna e Pejës, në vend që të kontraktoj shërbimet me një kosto më të lirë dhe të një kualiteti më të lartë duke kontraktuara Kompani të Specializuara për këto lloj shërbimesh ka Kontraktuar një Kompani e cila është shumë herë më e shtrenjtë në çmimin e ofruar se sa që këto shërbime janë kryer më herët apo edhe që mund të kryhen. Çmimet me të cilat janë kryer këto shërbime janë shumë herë më të shtrenjta se sa çmimet e tregut. Edhe pse më të shtrenjta janë të një kualiteti me të dobët nga fakti se kompania në fjalë nuk ka përvojën e duhur për këto lloje të shërbimeve (shih vendimin mbi dhënien e kontratës te dt. 24.10.2014) dhe këto shërbime janë kryer me një vlerë prej 51000 eurove, me çka ka bërë që AK të bie ndesh edhe me paragrafin 3 të nenit 35 të LPP-së. (citojmë: Ekzekutimi i një procedure të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës në asnjë mënyrë nuk e liron autoritetin kontraktues nga detyrimi i tij që (i) të luajë një rrol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancionet, (ii) të sigurojë që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut, dhe (iii) të vlerësojë me kujdes kualitetin e produktit, shërbimit ose punës në fjalë).

4. Duke analizuar të gjithë atë që u tha më lartë ne dyshojmë që kompanisë të cilës i është dhënë kontrata të ketë bërë ndonjë sigurim të ekzekutimit të kontratës apo të jetë negociuar për kushtet, afatet dhe llojin e shërbimit të ofruar.

**Procesi i prokurimit:**

*Data e njoftimit për kontratë në KRPP:*.....
*Lloji i procedurës së aplikuar:*.....Procedurë e negociuar pa Publikim te Njoftimit për Kontratë
*Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:*.....Shërbime/vlerë e Madhe
*Vlera e parashikuar e kontratë:* .....2.318,760.00 Euro
*Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):* .....
*Data e hapjes së ofertave:*.....03.04.2017
*Data e njoftimit për dhënie të kontratës në faqen e KRPP-së:*.....04.04.2017

**Kriteret për vlerësim:**

*Kriteri për dhënien e kontratës (N.60):* ..... Tenderi i përgjegjshëm ,Çmimi më i ulët.

*Kërkesat (administrative) për përshtatshmëri* (N.65-69):

1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.

*Dëshmitë dokumentare:*

2. Deklarata nën betim e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi(duhet dorëzuar së bashku me tenderin).

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet .

Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:

a. Për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.

b. Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.

*Kërkesat përshtatshmërisë profesional* (N. 66):

a. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
b. Regjistrimi në TVSH; dhe

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

a) Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);
b) Një kopje e certifikatës se TVSH; dhe

*Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare ( neni 68 të LPP-së )*

- Qarkullimi financiar në tre vitet e fundit 2014, 2015, 2016
- Sigurimi i tenderi 3,000.00€
- Sigurimi i ekzekutimit 10%, vlerës së kontratës

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

- Raportin apo raportet përkatëse nga një ose më shumë banka për qarkullimin financiar minimum 300,000.00€

*Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ( neni 69 të LPP-së )*

- Të paraqitni listën e shërbimeve të realizuara në tri vitet e fundit të kësaj lëmie së paku 3 (tri)
- Të përpiloni listën e mjeteve të nevojshme për ketë lëmi të shërbimeve
- Numri i mjaftueshëm i punëtorëve për realizimin e kontratës së paku 220 (dyqind e njëzet) punëtor ekzistues të punëve dhe shërbimeve të kërkuara.

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

- Lista e kontratave për shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit.
- Të dorëzohet dëshmi për posedimin e mjeteve në pronësi të operatorit për shërbimet e kërkuara
- Deklaratë me shkrim mbi pranimin e 220 punëtorëve për kryerjen e këtyre shërbimeve.

**Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N. 58):**

| Nr. | Emri i OE | Vendi | Çmimi |
|---|---|---|---|
| 1. | "KRM AMBIENTI" | Pejë | 64,410.00€ |

**Komisioni vlerësues pranë AK:**

*Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N. 59).*

Autoriteti kontraktues, ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderëve në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve, si në vijim:

- Gëzim Lajqi, Kryetar i komisionit
- Sami Gashi, Anëtar
- Alban Bushati, Anëtar

*Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimi:*..... 26.01.2017

*Data e njoftimit për dhënie të kontratës (N. 41):*.....04.04.2017

*Data e vendimit të AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE (N. 108/A):*.....13.04.2017

**Raporti i komisionit vlerësues:**

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni vlerësues konstatoj se operatori ekonomik "KRM AMBIENTI" që ka ofertuar, ne aktivitetin e prokurimit me titull **"Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre", me nr. të prokurimit: 635/17/038/215**, i plotëson kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit.

**Analiza dhe sqarimet e ekspertëve shqyrtues (N. 113, 114)**

***Sqarimi Nr.1:***

Ekspertja shqyrtues bazuar ne dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit me titull: **"Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre",** me nr. të prokurimit: 635/17/038/215, ka aplikuar procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Lloji i kontratës është kontratë publike kornizë 36 muajsh, shërbime, vlerë e madhe. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.

***Sqarimi Nr.2:***

Pretendimi i operatorëve ekonomik ankues ku thuhet: *"AK-Komuna e Pejës duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës ka bërë shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik, dhe është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të këtij ligji, konkretisht të nenit 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji"*, ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues është i obliguar që fondet publike dhe burimet publike të përdorë në mënyrë ekonomike, duke pasur parasysh qëllimin dhe lëndën e kontratës, prandaj autoriteti kontraktues në rast të kontraktimit të kontratës me vlerë me të lartë se kontrata e më hershme për këto shërbime, konform nenit 6 të LPP-së, ka përgjegjësi për mos shfrytëzim të drejt fondeve publike dhe burimeve publike.

*Sqarimi Nr.3:*

Pretendimi i operatorëve ekonomik ankues ku ceket: "*Edhe pse me kërkesë të gjithë OE të cilët merren me Shërbimet e Pastrimit dhe të mirëmbajtës së Objekteve dhe në emër të tyre i është dërguar kërkesë për qasje në dokumente zyrtare nga adresa zyrtare e Schafberger komuna e Pejës akoma edhe sot nuk ka kthyer përgjigje për lejimin apo jo të qasjes në këto dokumente duke bërë kështu edhe një tjetër shkelje të LPP-së konkretisht të nenit 10, Mjetet për Promovimin e Transparencës*", ekspertja shqyrtues bazuar ne shkresat e lëndës sqaron se operatoret ekonomik ankues përmes shkresës elektronike (e-malit) të dt. 06 prill 2017, adresuar autoritetit kontraktues kanë kërkuar qasje ne dokumentacionin e ofertës së Kompanisë KRM "AMBIENTI" Sh.A, për procedurën e negociuar në mes kësaj kompanie dhe Komunës së Pejës për kontratë me titull: **"Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre"**, me nr. të prokurimit: 635/17/038/215.

Bazuar ne shkresat e lëndës, ekspertja shqyrtues sqaron se ne kërkesën e operative ekonomik ankues të dt. 06 prill 201, ka hasur në shkrim ku thuhet: OE SCHAFBERGER" dhe OE "KRASNIQI" kanë pas qasje ne dosjen e tenderit me dt. 07 prill 2017, në ora 11.15, mirëpo është e nënshkruara vetëm nga njëra palë dhe jo nga palët tjera në qasje të dokumentacionit.

*Sqarimi Nr.4:*

Pretendimi i operatorëve ekonomik ankues ku thuhet: "*AK Komuna e Pejës gjithashtu ka bërë shkelje të LPP-së nëntit 7,trajtim/Jo Diskriminimi, paragrafi 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, nga që duke shpërblyer një operator me kontratë me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë ka eliminuar kështu nga konkurrenca dhe nuk ka trajtuar të gjithë OE të cilët do të mund te paraqesin ofertat e tyre ne këtë procedurë te prokurimit*", ekspertja shqyrtues vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik ankues është i bazuar për faktin se autoriteti kontraktues në rastin konkret nuk ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së ku thuhet: "autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik", për faktin se ftesën për pjesëmarrje në procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë ja ka bërë vetëm OE "KRM AMBIENTI", kur dihet se në treg ka më shumë se një kompani të cilat ofroj shërbime të pastrimi dhe sigurimit në Republikën e Kosovë.

*Sqarimi Nr.5:*

Pretendimi i operatorëve ekonomik ankues ku thuhet: "*AK Komuna e Pejës duke u munduar që të shpërblej në mënyrë të kundërligjshme dhe të shpallë fitues KRM AMBIENTI është munduar që të përdorë si kriter një nga procedurat e lejuara të LPP-së, konkretisht nenin 35, Procedura e Negociuar pa Publikimin e Njoftimit të Kontratës, respektivisht ku ceket jemi të bindur se AK. Komuna e Pejës me rastin e Njoftimit apo jo të KRPP-së, nuk ka dhënë arsye të qëndrueshme se pse ka përdorur këtë lloj të Procedurës së Prokurimit Publik*", ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të dt. 21 mars 2017, në harmoni me nenin 35 paragrafi 1 të LPP-së, e ka njoftuar KRPP-në për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre"**, me nr. të prokurimit: 635/17/038/215, ku thuhet:

Sipas nenit 35.2 të LPP-së, autoriteti kontraktues pa qëllim për diskriminim kundër apo në favor të ndonjë operatori ekonomik, ka përdorë PNPNJK. Arsyeja për marrjen e këtij vendimi është: Sipas propozimit të bordit të drejtorëve të NPL "Ambienti" sh.a., të dt. 04.04.2016, me nr. 444, drejtuar Komisionit Komunal të Aksioneve, për zgjerimin (shtimin) e veprimtarive të kësaj ndërmarrje publike. Ky komision pas aprovimit, ketë propozim ia rekomandon Asamblesë Komunale për Miratim.

Asambleja Komunale në takimin e vet të rregullt me dt. 10.05.2016, merr vendim me nr. 28/2016, me të cilin Miraton propozimin e Komisionit Komunal të Aksioneve dhe Bordi të NPL "Ambienti" sh.a. ne Pejë për zgjerimin e veprimtarisë së Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" sh.a., e cila është nën menaxhimin e Komunës së Pejës dhe me seli në Pejë. Pra merr vendim se pas veprimtarive që ka ushtruar kjo ndërmarrje gjerë me sot si veprimtari shtesë ti ushtroj edhe veprimtarit në vijim:

1. Pastrimin e të gjitha llojeve të objekteve
2. Veprimtarin e shërbimeve të përgjithshme, dhe
3. Veprimtarit tjera shërbyes.

Me marrjen e këtij vendim ne si autoritet kontraktues do të respektojmë nenin 35.2.3 (ii) që do t'i epet një autoriteti kontraktues që sipas një akti legjislativ ose rregullativ normativ ose nën normativ e gëzon një të drejtë ekskluzive për të siguruara shërbime të tilla.

Ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues me dt. 21 mars 2017, njëkohësisht ka parashtruar kërkesë në KRPP, për aprovimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, për aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre"**, me nr. të prokurimit: 635/17/038/215.

KRPP i kthen përgjigje autoritetit kontraktues ku ndër të tjera thuhet: sipas dokumentacionit dërguar në KRPP lidhur me përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre"**, me nr. të prokurimit: 635/17/038/215. Vendimi është marrë bazuar ne nenin 35.2.1.2.3 , nen paragrafi (ii) për të drejt ekskluzive për të ofruar shërbime (punë) të tilla. Ne fund të shpjegimit keni kërkuar pëlqimin e KRPP-së për përdorim të kësaj procedure.
Ju sqarojmë se sipas nenin 35 përkatësisht nenin 87 paragrafi 2.4 të LPP-së, përdorimi i PNPNJK është përgjegjësi të plotë të autoritetit kontraktues.

***Sqarimi Nr.6:***

Pretendimi i operatorëve ekonomik ankues ku ndër të tjera thuhet: "*KRM AMBIENTI nuk ka as përvojën dhe as njohurinë e duhur për të kryer një lloj të tillë të shërbimeve e aq më pak për të kryer shërbimet e sigurimit fizik te Objekteve të Komunës së Pejës, kur dihet mirë për fakti se shërbimet të tilla kërkojnë licenca të veçanta të cilat duhet të merren në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës e për të cilat KRM AMBIENTI as që ka aplikuar ndonjëherë e lër më ti ketë*", ekspertja shqyrtues sqaron, autoriteti kontraktues në nenin III. 2.4 të FTD-së, te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ka kërkuar: Listën e shërbimeve të realizuar në tri vitet e fundit të kësaj lëmie se paku tri/3; Dëshmia dokumentare: Lista e kontratave të shërbimeve të ngjashme në tri vitet e fundit, ndërsa operatori ekonomik KRM "AMBIENTI", si dëshmi ka ofruar vetëm një kontratë me Komunën e Pejës lidhur me aktiviteti e prokurimit "Larja dhe fshirja e rrugëve, mirëmbajtja e varrezave, sipërfaqeve të gjelbëruar dhe ndriçimit".

Bazuar ne atë që u tha më lartë, rezulton se operatori ekonomik KRM "AMBIENTI", nuk e ka ofruar dëshmi ashtu siç është kërkuar në nenin III. 2.4 të FTD-së, ku thuhet: "Lista e kontratave të shërbimeve të ngjashme në tri vitet e fundit".

Ndërsa sa i përket asaj ku thuhet ndër të tjera se *OE "KRM AMBIENTI" nuk ka përvojë aq me pak në shërbimet e sigurimit fizik te Objekteve të Komunës së Pejës, kur dihet mirë për fakti se shërbimet të tilla kërkojnë licenca të veçanta të cilat duhet të merren në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës e për të cilat KRM AMBIENTI as që ka aplikuar ndonjëherë e lër më ti ketë,* ekspertja shqyrtues duke pasur parasysh vlerën e parashkruar të kontratës si dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike, vlerëson se në rastin konkret autoriteti kontraktues është dashur që në dosjen e tenderit, të parasheh edhe kërkesat minimale për kualifikim të operatorit ekonomik për shërbime të sigurimit, ashtu siç kërkohet edhe ne nenin 51 të LPP-së dhe në nenin 26 të Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimi Publik, të cilat kërkesa janë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës, më qëllim që të respektohet parim bazë i LPP-së, "*Vlera për paranë*".

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:**

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre"**, me nr. të prokurimit: 635/17/038/215, si dhe duke pasur parasysh konstatimin nr. 6, i propozon panelit shqyrtues që ankesën e operatorëve ekonomik ankues ta aprovoj si të bazuar, ndërsa të anuloj vendimin- njoftimin për dhënie të kontratës të autoritetit kontraktues, të dt. 04 prill 2017, dhe lëndën ta kthej në Ri-tenderim.